

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.08(386)

GUSHT 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: WWW.VETERANIOBVL.ORG

HISTORIA



Brigada e Parë, njësia e parë e madhe dhe e organizuar e UNCÇL

FAQE 2

TREGIM



EDHE JU JENI TRIMA....!

Nga Myfit GUXHOLLI

FAQE 7

PROFIL



Ismail Bara, ish partizan i Brigadës 18 -të, aktivist dhe drejtues me vlera shoqërore

Muharrem GJOKA -Nënkryetar i OBVL

FAQE 5

Në vlerësimin e historisë së LANÇ, OBVL është e qartë në atë “çfarë është në gjëndje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut: Është në gjëndje të bëjë EPOPE”

OBVL synon bashkimin e veteranëve në një organizatë të vetme

Nga Maksim VINÇANI, Nënkryetar i OBVL

Zgjedhjet si test për funksionalitetin e sistemit

Halil RAMA

Çdo demokraci ka nevojë që herë pas here të testojë funksionalitetin dhe efikasitetin e institucioneve të saj, e zgjedhjet janë ato që pikërisht e mundësojnë këtë. Si një prej instrumenteve më të rëndësishme të demokracisë sot, zgjedhjet shërbejnë si rrugë për pjesëmarrje të qytetarëve në procese politike. Duke zgjedhur ata që përfaqësojnë më së miri vlerat dhe interesat e popullit, votuesit mund të ndikojnë në formësimin e politikave që përmirësojnë kualitetin e jetës së tyre.

Parë nga ky këndvështrim OBVL përshëndet nismën për ndryshimet kushtetuese që konsistojnë në hapjen e listave. Kjo edhe për faktin se sistemi proporcional rajonal me lista të mbyllura sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008 rezultoi difektoz dhe prodhoi destabilitet e krizë besimi mes palëve.

Sistemi me lista të hapura, për të cilin me sa duket do të bien dakord palët, është aplikuar dhe aplikohet me sukses në dy shtetet fqinje, atë të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Ja, pra, përvojën e kemi fare pranë.

Opozita reale (ajo jashtëparlamentare) për shumë arsye duhet të insistojë që sistemi i votimit me lista të hapura të mbetet si alternativë e vetme për ndryshimet kushtetuese. Një prej arsyeve se pse ky sistem është më demokratik dhe më përfaqësues është se i siguron votuesve mundësinë që brenda listës së një subjekti politik të votohet kandidati i tij i preferuar. Me këtë sistem, qytetarët drejtpërdrejt ndikojnë në zgjedhjen e kandidatëve në listat e ofruara nga partitë politike.

Përparësi tjetër e këtij sistemi zgjedhor është se zvogëlon fuqinë e partisë që mund të jetë e centralizuar tërësisht brenda një grupi të vogël të personave që janë afër figurave kyçe brenda subjektit.

Për dështimin e sistemit me lista të mbyllura flasin dhe akuzat e shumta për deformimin e votës së shqiptarëve me anë të blerjes së votës e inkriminimit të zgjedhjeve, duke përfshirë në lista elementë me të shkuar kriminale.



FALENDERIM

Gjej rastin t'ju shpreh mirënjohjen time më të thellë dhe të falenderoj për zëmërisht të gjithë bashkëluftëtarët, miqtë dhe bashkëpunëtorët që më uruan në 90-vjetorin e ditëlindjes.

Edhe njëherë i shpreh mirënjohje të veçantë Presidentit të Republikës së Shqipërisë, SHT Z. Ilir Meta, i cili me propozimin e kryesisë së OBVL-së më akordoi “Dekoratën e Artë të Shqiponjës”.


Kolonel Ing. Myfit GUXHOLLI
Kryetar i OBVL

Kur u formua OBVL nga frymëzuesit e saj, dr. Ymer Dishnica, Gjeneral Parllaku, Liri Belishova, Skënder Malindi, Edip Ohri etj., kishte si qëllim misionin e bashkimit të gjithë veteranëve në një organizatë të vetme, duke lënë mënjanë ngjyrimet partiake. Platforma e saj, synonte për ta paraqitur Luftën Antifashiste si luftë e të Gjithë Popullit Shqiptar ashtu siç kishte ndodhur, pa shtrembërimet politike, por si vazhdues të mesazheve të Konferencës së Pezës për pajtim dhe bashkim Kombëtar. Këto, në bazë të murrëqiptimit dhe tolerancës duke qënë kështu më efikase në evidentimin e traditave luftarake e patriotike dhe për t'i përcjellë brezave të rinj mesazhin, se interesat e atdheut janë më të shenjta dhe qëndrojnë më lart se ato të partiake

FAQE 3

LIBRI

Shënime rreth librit të publicistit të mirënjohur kosovar, nga Prizreni, Bashkim Hisari



HISTORI TRAGJIKE NGA LUFTA SHQIPTARO - SERBE

Dr. Hajri Mandri

FAQE 12

PËRVJETORËT

Gushti i 1944 muaji i krijimit të Brigadave partizane të 14, 16, 18 dhe 19 S

FAQE 4-6

HOMAZH

Major DINE XHEKA, modeli më i mirë i oficerit të Ushtrisë Shqiptare

Ali Demushi

FAQE 9

PROFIL

ARBEN DUKA ËSHTË NJËRI NGA LIRIKËT TANË MË TË MIRË

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 11

PORTRET

Akademik Gazmend Zajmi, figurë e ndritshme intelektuale e Kosovës

FAQE 3

TREGIM

Për tek Porta e Ligjit.....?!

Nga Liljana Muça

FAQE 6

TURIZMI

GUSHT 2020, NË PUKË PESË JUBILARË PËRKUJTIMESH DHE PROMOVIMESH

Nga Xhemal MEÇI

FAQE 10

HISTORIA

Brigada e I-rë ishte i pari formacion i madh i Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare

Njësia e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare

Ruga luftarake e Brigadës së I-rë Sulmuese, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë është e mbushur me vepra heroizmi, vetmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe Atdheut. Jeta dhe veprimtaria e saj është aq e pasur me ngjarje dhe vepra revolucionare, politike e ushtarake të cilat kurrësi nuk mund të përshkruhen në një artikull, në një apo dy libra, por në shumë vëllime.

Udhëzimet për krijimin e Brigadës së I-rë u lëshuan më 20 qershor 1943. Pikësynimi ishte që krijimin i këtij formacioni të parë të madh të shërbente për t'i dhënë vrull krijimit të batalioneve e brigadave të tjera, të një ushtrie të rregullt partizane, të cilat do të ngjallnin një besim të madh për zhvillimin e luftës sonë, drejt Kryengritjes së Përgjithshme.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u hodhën themelet e Ushtrisë së rregullt popullore shqiptare. Brigada e I-rë ishte i pari formacion i madh i kësaj ushtrie të rregullt. Kjo brigadë nuk ishte një repart krahe ose qarku, siç ishin çetat, batalionet dhe grupet. Ajo ishte një njësi luftarake në dorë të Shtabit të Përgjithshëm, me partizanë nga të gjitha qarqet e vendit, që do të luftonte, lëvizte dhe manovronte në të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku të paraqitej nevojja.

Brigadës së I-rë, si formacion i madh i ushtrisë së rregullt partizane ju ngarkua nga Shtabi i Përgjithshëm detyra që të shërbente si shembull për repartet partizane të të gjitha krahinave, për shndërrimin e tyre në formacione të rregullta. Pra, Shtabi i Përgjithshëm i kishte marrë të gjitha masat politike e organizative që Brigada e I-rë të bëhej me të vërtetë bërthama e shëndoshë për ushtrinë e rregullt.

Të gjitha qarqet e Shqipërisë kishin marrë udhëzime që kontigjentet e caktuara të ishin partizanë e kuadro me përvojë luftarake.

Qarqet e Korçës, Gjirokastrës, Elbasanit e Vlorës do të dërgonin grupet me numër më të madh partizanësh e kuadrosh. Shtabi i Përgjithshëm synonte që kjo njësi të organizohej, paisej dhe plotësohej me një efektiv të pathyeshëm dhe të drejtuar nga kuadro me përvojë ushtarake e revolucionare të lartë, për të përballuar goditje nga më të fuqishmet që do të organizonte armiku. Ky sulm i okupatorit ishte në planin e tij strategjik me qëllim që të pengonte me çdo kusht shkallëzimin e mëtejshëm organizativ e numerik të një ushtrie të rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare. Këtë qëllim armiku e tregoi dhe në ditët e inagurimit të Brigadës së I-rë duke angazhuar 10 000 trupa me paisjet luftarake më moderne të kohës, plus forcave të Ballit, milicisë, aviacionit etj, për ta asgjësuar atë që në krijimin e saj.

ORGANIZIMI I NJËSISË

Shtabi i Përgjithshëm zgjodhi vendin më të përshtatshëm, rajonin e Vithkuqit për organizimin e Brigadës së I-rë. Katundi Vithkuq, 20 km në jugperëndim të Korçës, terren malor, ishte i përshtatshëm për të organizuar mbrojtjen. Popullsia e Vithkuqit dhe e fshatrave për rreth ishte 100 përqind në mbështetje të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Grumbullimi i grupeve partizane të ardhura nga drejtimet e caktuara filloj që në fundin e muajit korrik '43. Të parat erdhën forcat e Korçës (rreth 200 partizanë e kuadro) të cilat u vendosën në Manastirin e Shën Pjetrit. Më vonë mbërriti grupimi i Gjirokastrës që zuri vend në Pyllin e Shtyllës. Deri më 2 gusht mbërritën të organizuar edhe vullnetarët partizanë të qarqeve të Elbasanit, Beratit e Vlorës. Partizanë të veçantë pati dhe nga Tirana, Dibra, Durrësi, Kukësi e Shkodra. Në efektivin e Brigadës I-rë erdhën dhe dhjetë vajza partizane. Në fillim Briga-



da pati një efektiv prej 556 partizanë. Midis tyre 70 kishin qenë kuadro drejtuese si komandantë e komisarë batalionesh e çetash, komandantë njësitësh guerrile, me përvojë të pasur luftarake e të kalituri në vështirësi.

Në datën 10 gusht përfundoi organizimi i Brigadës me katër batalione dhe tre kompani: një kompani mortajash, një kompani pushk kundërtank dhe një bateri artilerie. Një vëmendje e posaçme iu kushtua shërbimit të intendencës. Shtabi i Përgjithshëm për këtë shërbim kishte parasysh se Njësia do të lëvizte nga një krahinë në tjetrën, herë-herë me shpejtësi të madhe. Kuptohet që Brigada duhet të kishte një furnizim dinamik, sidomos me municione. Prandaj ndërtimi i këtij shërbimi u organizua në përshtatje me kërkesat e detyrat e Njesisë. Një përforsim i veçantë ju bë intendencave të batalioneve.

15 GUSHT 1943 - DITA E INAGURIMIT

Po afrohej 15 gushti, dita e inagurimit. Ceremonia do të zhvillohej në fushën e vogël të Makërzës, që shtrihet në luginën midis kodrave e pyjeve.

Në Vithkuq prej dy javësh qëndronte Shtabi i Përgjithshëm dhe udhëheqës të tjerë të Luftës. Qarkori i Korçës kishte marrë të gjitha masat përgaditore për festën dhe mbrojtjen e nevojshme me forcat e vendit. Në sheshin e Makërzës ishin vendosur banderola, flamuj e parulla të ndryshme dhe në qendër tribuna me gjethe e mjete rrethanore. Që në orët e para po vinin aktivistë të fshatrave e qyteteve si nga Korça, Pogradeci, Erseka, Devolli etj. Në orën 9.00 u rreshtuan para tribunës katër batalionet dhe repartet e armëve të rënda me të gjitha pajimet dhe armatimet e tyre. Në mëndjet dhe zemrat e gjithë efektivit të Brigadës ndjehej një gëzim dhe gjallërim i pakufijshëm. Ishte nder i madh të bëje pjesë në këtë brigadë, që ishte njësi e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare. Në sytë e sejcilit lexohe gëzimin, krenarinë dhe vendosmërinë për t'i kryer detyrat luftarake deri

në vetëflijim.

Të gjithë prisnin me padurim fillimin e ceremonisë. Në orën 10 mbërritën udhëheqësit e PK me E.Hoxhën në krye dhe të Shtabit të Përgjithshëm, të cilët zunë vend në tribunë.

Ceremonia u hap me hymnin e flamurit, kënduar nga kori. Pastaj e mori fjalën Spiro Moisiu, Komandant i Shtabit të Përgjithshëm i cili përshëndeti në emër të Shtabit të Përgjithshëm, duke dorëzuar flamurin në formë trekëndëshi me shkabën dykrenare dhe me yllin e artë, me mbishkrimin: "Brigada e I-rë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare". Ai u shpreh: "Ju dorëzoj këtë flamur në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe kam porosi prej tij t'ju them që të mos e lini kurrë të bjerë në duart e armikut, por ta ngrini gjithmonë lart e ta çoni nga fitorja në fitore".

Komandanti i Brigadës, shoku Mehmet Shehu e mori flamurin dhe në emër të luftëtarëve bëri betimin përpara Shtabit të Përgjithshëm me fjalët: "Betoheh se këtë flamur që na dorëzoi Shtabi i Përgjithshëm do ta mbajmë kurdoherë lart. Do të jemi besnikë ndaj popullit dhe do të zhvillojmë luftë të paepur kundër fashizmit okupator dhe armiqve të popullit, për krijimin e një Shqipërie të lirë dhe demokratike popullore". Këtyre fjalëve ju bënë jehonë zërat e njëkohshëm dhe të zjarrtë të partizanëve: "Betohemi". Gjithë sheshi gjëmoi nga duartrokitjet dhe thirrjet e të pranishmëve "Rroftë Brigada e I-rë Sulmuese" etj. Në këtë ceremoni folën oratorë të ndryshëm.

Ceremonia u mbyll me parakalimin e Brigadës. Në fushë nuk ndjehej asgjë përveç hapit luftarak të partizanëve. Oshëtimat e hapit përcillej larg nëpër pyje e male. Pas ceremonisë, deri vonë në mbrëmje buçitën këngët dhe vallet partizane...

Efektivi i Brigadës së I-rë pati vazhdimisht ndryshime. Më 8 tetor Brigadës iu shtuan edhe 150 partizanë italianë, të cilët formuan Batalionin "Antonio Gramshi" dhe në fund të marsit "44 u shtua edhe batalioni i 5-të. Brigada arriti kështu një efektiv prej 1237 luftëtarësh.

REAGIMI

Në vlerësimin e historisë së LANÇ, OBVL është e qartë në atë “çfarë është në gjëndje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut: Është në gjëndje të bëjë EPOPE”

OBVL synon bashkimin e veteranëve në një organizatë të vetme



Maksim VINÇANI
Nënkrjetar i OBVL

- *Kur u formua OBVL nga frymëzuesit e saj, dr.Ymer Dishnica, Gjeneral Parlaku, Liri Belishova, Skënder Malindi, Edip Ohri etj., kishte si qëllim misionin e bashkimit të gjithë veteranëve në një organizatë të vetme, duke lënë mënjanë ngjyrimet partiake. Platforma e saj, synonte për ta paraqitur Luftën Antifashiste si luftë e të Gjithë Popullit Shqiptar ashtu siç kishte ndodhur, pa shtrembërimet politike, por si vazhdues të mesazheve të Konferencës së Pezës për pajtim dhe bashkim Kombëtar. Këto, në bazë të mirëkuptimit dhe tolerancës duke qënë kështu më efikase në evidentimin e traditave luftarake e patriotike dhe për t'i përcjellë brezave të rinj mesazhin, se interesat e atdheut janë më të shenjta dhe qëndrojnë më lart se ato të partiake*



për vërtetësinë dhe qëndrimin apo statusin e Organizatave tona.

Një historik i shkurtër i dy subjekteve të veteranëve. Të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre.

A-Komiteti Kombëtar i Veteranëve të Luftës Antifashiste, Nacional-Çlirimtare. Themeluar në vitin 1957. Programi i këtij Komiteti (i justifikuar për ato kohëra) ka qënë: “mbrojtja e vlerave të Luftës Antifashiste N.Çl. në Shqipëri; i idealeve të komunizmit, propogandimin dhe mbrojtjen e vijës së Partisë për focimin e diktaturës së proletariatit dhe luftës së klasave”. Ndërsa sot ky Komitet nuk e ka gjetur ende kura-jon për të pranuar publikisht ndonjë gabim të së kaluarës e për t'u diferencuar nga ato defekte që shoqëria shqiptare përpiqet t'i lejojë prapa.

B-Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar (OBVL). Themeluar në Shkurt/1994, njohur nga Ministria e Drejtësisë, Korrik/1994.

Kur u formua OBVL nga frymëzuesit e saj, dr.Ymer Dishnica, Gjeneral Parlaku, Liri Belishova, Skënder Malindi, Edip Ohri etj., kishte si qëllim misionin e bashkimit të gjithë veteranëve në një organizatë të vetme, duke lënë mënjanë ngjyrimet partiake. Platforma e saj, synonte për ta paraqitur Luftën Antifashiste si luftë e të Gjithë Popullit Shqiptar ashtu siç kishte ndodhur, pa shtrembërimet politike, por si vazhdues të mesazheve të Konferencës së Pezës për pajtim dhe bashkim Kombëtar. Këto, në bazë të mirëkuptimit dhe tolerancës duke qënë kështu më efikase në evidentimin e traditave luftarake e patriotike dhe për t'i përcjellë brezave të rinj mesazhin, se interesat e atdheut janë më të shenjta dhe qëndrojnë më lart se ato të partiake. Gjithashtu: OBVL është organizatë patriotike pluraliste. Vlerëson lart

dëshmorët e luftës, do të mbrojnë objektet, lapidarët dhe kujtimin e heronjve të luftës dhe do synojë në përpjekjet kundër përçarjes dhe për bashkimin përfundimtar në një organizatë të vetme të veteranëve. Dënon ato forca politike që kanë bashkëpunuar me okupatorin, dënon veprimtarinë përçarëse dhe diktatoriale të E.Hoxhës dhe klikës së tij, që tradhëtuan idealet e LANÇ duke dëmtuar rëndë shtetin dhe kombin tonë, mbështet proceset demokratike në Shqipëri e Kosovë. Lartëson luftën e popullit të Kosovës dhe vlerat e UÇK, si dhe kontributin gjatë Luftës Antifashiste të shqiptarëve në Maqedoni e Greqi.

OBVL është e hapur, jo ekskluzivisht vetëm për veteranët e LANÇ, pasardhësit dhe trashëgimtarët e tyre, por edhe për ushtarakët aktivë apo veteranë, për të rinj e të reja, për çdo shqiptar në Ballkan e diasporë që e ndien për detyrë të kontribuojë për evidentimin dhe vlerësimin e traditave patriotike të popullit tonë në luftat për liri dhe për mbrojtjen e trojeve Shqiptare.

•Në biseda private, eksponentë të Kom. Komb. të Veteranëve “akuzojnë” OBVL, sikur e krijoi PD si kundër peshë. Ne nuk e mohojmë përkrahjen e Qeverisë së atëherëshme, por nuk kemi qënë asnjë herë në shërbim të konjunkturave politike. OBVL është realisht e pavarur dhe pluraliste brënda saj, por mënyra se si Komiteti i Veteranëve bën vlerësimin e mësipërm, buron nga pikpamjet dhe nga “metri” me të cilin disa prej tyre, që e kanë të vështirë të ndahen nga e kaluara e tyre ideologjike, “matin” veten e tyre politikisht. OBVL ndihet deri diku e diferencuar nga Shteti, në raport me Kom. e Veteranëve, gjë që reflektohet në protokollet apo fondet; por këto nuk luajnë asnjë rol për të na dekurruar në misionin tonë. OBVL nuk bën revansh. Ajo nuk do përdorë asnjëherë ndonjë qeveritar për interesa të ngushta, por

njëkohësisht nuk do të lejojë në asnjë rast që të përdoret për interesa politike. OBVL është kundër me përdorimin e termave, me qëllim fyerje, të formës: “pinjollët e ...”, “seksion i B. Kombëtar...” apo “org. bazë e P. Punës”.

•OBVL i vlerëson ngjarjet historike, duke marrë në konsideratë kushtet që i paraprinë, kushtet reale të kohës kur kanë ndodhur si dhe pasojat që sollën në vazhdim këto ngjarje. Por nga ana tjetër mendon se, më shumë, këto janë tema që i përkasin analistëve, historianëve e akademikëve të pa indoktrinuar, me qëllim njohje të vërtetësive historike objektivist, gjë që në të kaluarën nuk u bë me vërtetësi. OBVL i përmbahet parimit se: “Pasardhësit nuk ka pse të kenë as merita dhe as përgjegjësi për veprimtaritë e të parëve, të të gjitha drejtimeve; veprimtari këto, që në fund të fundit, pasqyrojnë pjesë të historisë sonë. Meritë apo përgjegjësi do të ishte vlerësimi objektiv i të kaluarës”. Ndërkohë, është obligim kombëtar që, shteti e shoqëria shqiptare në kremtimet përkatëse duhet pa tjetër të kujtojë, të nderojë e të vlerësojë të rënë, protagonistët dhe gjithë atë periudhë të lavdishme patriotike të historisë së popullit tonë; larg politizimeve dhe larg pozicioneve pompoze, triumfale e ngadhënjyese, por si ngjarja më madhore e historisë sonë të re, ku populli patriot shqiptar bëri detyrën e tij ndaj Atdheut.

•Në vlerësimin e historisë së LANÇ ne përqëndrohemi në atë që, “çfarë është në gjëndje të bëjë populli ynë kur e thërret zëri i Atdheut: është në gjëndje të bëjë EPOPE”. Duke iu dhënë kështu brezave një mesazh të qartë krenarije për sakrificat dhe arritjet e Ushtrisë Partizane, që nëse e do përsëri situata, populli patriot do ta

PËRVJETORËT

Goditjet që i dha armikut brigada e 14 sulmuese, në qarkun e Gjirokastrës e detyruan atë të mbyllej në vendet e fortifikuara

Brigada XIV Sulmuese që çliroi Gjirokastrën

Gushti i nxehtë i vitit 1944 mund të quhet edhe muaji i krijimit të Brigadave partizane: Brigadës së 14, 16, 18 dhe 19. Ndërkohë që në gushtin e vitit 1943 ishte krijuar famëmadhja Brigada e Parë.



Shtatëdhjetegjasthtë vjet më parë, më 17 Gusht 1944, në Sheper të Zagories u krijua Brigada e XIV Selmuese Partizane. Në përbërje të saj u përfshijnë gurpi i I i Kurveleshit, grupi i 3 i Mallakstrës dhe grupi i 4 Çamëria që bënë pjesë në zonën e I operative Vlorë-Gjirokastrë. Komanadanti i brigadës u zgjodh Gjon Banushi dhe komisar Karaman Ylli.

Brigadës i ngarkua një sektor i gjerë veprimi që përfshinte Libohovë-Pogon, Lunxhëri-Cepo-Rrozom. Goditjet që i dha armikut brigada e 14 sulmuese, në qarkun e Gjirokastrës e detyruan atë të mbyllej në vendet e fortifikuara në bashkëpunim edhe me forca të tjera partizane ajo nuk e la të qetë armikun.

Një nga këto beteja është sulmi mbi kalanë e Borshit dhe forcave armike në bregdetin e Sarandës. Luftimet e ashpra bënë të mundur që

forcat partizane të vinin nën kontroll kalanë e Borshit dhe pjesën më të madhe të bregdetit të Sarandës.

Gjirokastra që një disa luftime të zhvilluara në qarkun e saj por edhe më gjerë, ato të 2 tetorit 1943 kundër forcave naziste të zhvilluara në urën e Kardhiqit e Manastirin e Cepos por edhe në kantundin Gjon të Vlorës të zhvilluar nga Batalioni Asim Zenel e batalioni Halim Xhelo të cilët formuan edhe grupin e I partizan të zonës së I operative Vlorë-Gjirokastrë e që zhvilluan një sërë luftimesh si ato të 18 Nëntorit 1943 për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës e që banorët gjirokastritë dolën nëpër rrugët e qytetit duke i pritur me shumë mall e dashuri partizanët e këtyre batalioneve por edhe luftimet e zhvilluara në Përmet e në Këlcyrë dhe në Qafën e Këçikut kundër autokolonës gjemane të shoqëruar me tanke e autobline por armiqtë që e kishin lakmi Gjiroka-

trën e pushtuan përsëri kështu më 2 Gusht 1944. Brigada e 8 sulmoi pushuesit nazistë në Gjirokastrë dhe hyri në disa lagje të qytetit. Fill pas veprimeve luftarake në Gjirokastrë ajo kaloi në krahinën e Konispolit dhe së bashku me grupin e zonës së I operative më 26 gusht çliroi Konispolin.

Nga muaji Shtator 1944, në qytetin e Gjirokastrës ndodheshin 500 forca gjermane dhe 250 xhandarë e ballistë të cilët ishin vendosur në vendet të fortifikuara dhe zotëruese siç ishte kalaja e qytetit përveç kësaj garnizoni nazist mbrohej edhe nga mjaft armë zjarri të fuqishme si artileri e mitrolozë të rëndë. Pikërisht në këtë kohë komanda e brigadës 14 sulmuese mori vendim në bashkëpunim edhe me disa forca të brigadës 19, batalionin Thana Ziko të sulmonte garnizonin armik të Gjirokastrës dhe ti kthente lirinë e humbur 2 herë me çdo kusht qytetit. Gjithashtu u vendos që të goditej edhe garnizoni nazist në Jorgucat që forcat e këtyre 2 garnizoneve të mos kishin mundësi të bashkëvepronin. Më 17 shtator lufta u ndez e ashpër në periferi të qytetit. Armiqtë përballuan me vështirësi sulmet e partizanëve dhe u terhoqën në pozicione shumë të fuqishme. Partizanët u futën në qendër të qytetit e në disa lagje ku qëndruan për disa orë. Në mëngjes ata u tërhoqën e zunë vend në periferi të qytetit. Në 18 shtator të 1944 forcat partizane filluan sulmin e ashpër Që në minutat e para, beteja ishte e rreptë dhe në afërsi deri në bomba dore por shpejt një pjesë e forcave armike u tërhoqën në panik dhe u futën në kalanë e qytetit. Partizanët sulmuan kalanë të cilën e çliruan. Çlirimi i kalasë mori fund në gjithë qytetin e Gjirokastrës, u çlirua njëherë e përgjithmonë. Dita e 18 shtatorit 1944 në Gjirokastrën e çliruar valoi fitimtar flamuri i lirisë prandaj kjo ditë përkujtohet e do të përkujtohet edhe këtë 76 vjetor të këtij viti dita e çlirimit të qytetit.



BRIGADA XVI SULMUESE E UNÇSH - Brigada partizane e rinisë

Brigada XVI u inaugurua më 20 gusht 1944 në Therapel të Skraparit. Ky formacion i fuqishëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare vërtet u përrua më 20 gusht, por pagëzimin e zjarrit të betejave e fitoreve partizanët e saj e kishin bërë gjatë viteve të luftës për liri. Ky formacion i fuqishëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare vërtet u përrua midis skraparllinjve trima e patriotë të pashembullt, por në përbërjen e vet përfshiu edhe partizane e partizanë, vajza e djem të guximshëm e të sakrificës nga trevat e tjera atdhetare, Myzeqeja, Labëria e Mallakstra.

Brigada XVI u krijua nga bashkimi i ish formacioneve të njohura partizane: grupi i tretë i Skraparit, grupi i tretë i Mallakstrës, grupi i parë i Kurveleshit dhe grupi i Myzeqesë. Përveç 200 partizanëve të Brigadës XVI-të, Myzeqeja u bë burim edhe për Brigada të tjera të Ushtrisë partizane: 52 partizanë myzeqarë u rreshtuan në Brigadën e I-rë, 120 në Brigadën e VII-të, 82 në Brigadën e VIII-të, 70 në Brigadën e X-të etj.

Brigada XVI mund të quhet ndryshe edhe Brigada partizane e rinisë. Ndër 560 partizanet e partizanët e saj, më shumë se 85 përqind ishin në moshë të re, 15-30 vjeçarë dhe rreth 70 prej tyre ishin vajza. Brigada XVI luftoi kryesisht në trekëndëshin Berat Lushnje-Fier dhe e shndëroi Myzeqenë në një arenë betejash të përgjakshme kundër nazistëve dhe kolaboracionistëve. Brigada XVI luftoi me një ushtri armike të mirëpajisur me armatimet më të rënda dhe bandat e bashkëpunëtorëve vendas në mbështetje të tyre.

Brigada XVI ngrii në altarin e lirisë 56 vajza e djem të bukur e trima, shumica e të cilëve ranë dëshmorë në lulen e rinisë.

Faktet flasin se fitorja e LANÇ dhe çlirimi i Shqipërisë janë vulosur me 68 muaj luftë dhe sakrificat e 70 mijë luftëtarëve dhe 28 mijë dëshmorëve.

Lavdi të përjetshme partizaneve dhe partizanëve të Brigadës XVI Sulmuese!

Nderim e mirënjohje të paku-fishme partizanëve, çlirimtarëve të Shqipërisë, familjeve të dëshmorëve, veteranëve e pasardhësve të tyre!"

OBVL synon bashkimin e veteranëve në një organizatë të vetme

(Vijon nga faqja 3)

përsërisi sa herë të jetë nevoja; por asnjëherë si instrument për vendosjen e një rendi në shërbim të instalimit të ndonjë ideologjie, apo për objektiva politike; por vetëm për mbrojtjen e vendit nga pushtues të huaj.

OBVL nuk iu rekomandon anëtarët e saj që të votojnë parti të caktuara politike, kjo të jetë zgjedhja personale e gjithësecilit. Ndërkohë, pavarësisht se cilat ishin paramendimet ideologjike për regjimin e pasluftës në Shqipëri (temë më vete

kjo), nuk mund të mos merret parasysh merita dhe kontributi i komunistëve patriotë për rolin në organizimin me sukses të Luftës kundër pushtuesit, të cilët prekën me shumë rezultat pikën e ndjeshme të shqiptarëve: partiotizmin, (ndryshe do të ishim të padrejtë).

Së fundi: Shpresojmë dhe urojmë që dy Organizatat tona t'i kalojnë paragjykimet dhe të bashkohen në një organizatë të vetme, duke iu lënë pasardhësve amanetin që të jenë të bashkuar në mbrojtjen e vlerave patriotike të Shqiptarëve, duke vënë në plan të parë interesat atdhetare para interesave ideologjike.

PROFILI

Që me krijimin, në radhët e Brigadës 18 ishte edhe Ismail Bara, i cili gjithë jetën ia kushtoi atdheut dhe popullit të tij

Ismail Bara, ish partizan i Brigadës 18 -të, aktivist dhe drejtues me vlera shoqërore

Për merita të veçanta gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe mbas çlirimit, Presidumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me 8 Urdhëra e Medalje. Në vitin 2004, me rastin e 60-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë Ismail Bara u dekorua me Medaljen "Për Kontribut të Shquar në Çlirimin e Atdheut".



Muharrem GJOKA
Nënkryetar i OBVL`

KRONOLOGJI

Më 18 gusht 1944, sipas urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm u formua në Sllatinë të Dibrës Brigada e 18-të S mbi bazën e tre batalioneve të Dibrës, Martaneshit, Çermenikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Miço Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar. Gafur Korca ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

Që me krijimin e kësaj brigade, në radhët e saj ishte edhe Ismail Bara, i cili gjithë jetën ia kushtoi çshtës së atdheut dhe popullit të tij.

BIR I NJË FAMILJE TË NDERUAR DHE ME TRADITA ATDHETARE NDËR BREZA

Ismail Bara lindi më 10.5.1926 në fshatin Manesh të krahinës Zall Dardhë të Dibrës në një familje të nderuar dhe me tradita atdhetare ndër breza.

Xhaxhai i tij Ismail Avdi Bara u vra në luftën kundër serbëve më 1913 dhe është shpallur dëshmor i Atdheut. Ai ishte shoqëruar i përhershëm i patriotëve të njohur Elez Isufi dhe Isuf Xhelili. I rritur dhe



edukuar nga një familje e tillë, edhe Ismaili që në moshë të re, në pranverën e vitit 1943, u radhit në çetën partizane të Dibrës që komandohej nga Haxhi Lleshi.

Më 18 gusht 1944, me krijimin e Brigadës 18-të Sulmuese, Ismaili inkuadrohet në njësitë e kësaj Brigade me detyrën e përgjegjës të rinisë të Kompanisë. Mori pjesë në të gjitha aksionet e kësaj brigade si në Dibër, Kukës e Prizren. Ai qëndroi trim dhe i vendosur deri në çlirimin e plotë të Atdheut nga pushtuesit nazifashistë. Më 27 janar 1945 Ismaili u transferua në Divizionin e Mbrojtjes së Popullit me detyrë komanduese në ndjekjen e bandave të armatosura kriminale, që vepronin me dhunë për rrëzimin e pushtetit popullor në rrethet e Kukësit, Shkodrës, Pukës dhe Mirditës. Ai punoi dhe luftoi me shumë përkushtim në vendosjen e rendit dhe qetësisë publike.

NDËR SHEFAT MË TË MIRË TË QARKULLIMIT RRUGOR

Më 10 maj 1947, Ismaili transferohet në organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shërbeu në sektorin e policisë si komandant poste në rrethet Shkodër, Pukë, Dibër e Bulqizë.

Në harkun kohor qershor 1954 - korrik 1956 kreu studimet në Shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe u titullua "oficer". Mbas mbarimit të shkollës së Policisë, më 30 korrik 1956 u emërua inspektor i Qarkullimit Rrugor në rrethin e Dibrës për t'u kujdesur në vendosjen e rregullave për lëvizjen me korrektesë të automjeteve në sektorin e ndërtimit të hidrocentraleve Ulëz dhe Shkopet, duke bërë kujdes të madh për mbrojtjen e jetës së vullnetarëve dhe punonjësve gjatë punës. Më 20 qershor 1957 emërohet inspektor i qarkullimit rrugor Mat (sektor i ndërtimit të dy hidrocentraleve Ulëz - Shkopet) detyrë të cilën e kreu me përkushtim, profesionalizëm e kompetencë deri në vitin 1963.

Po me të njëjtën përgjegjësi sherbeu Ismail Bara edhe gjatë viteve 1963-1966 si shef i Qarkullimit Rrugor Krujë-Kurbinit me gradën "Kapiten i Parë". Ndërsa në vitin 1967 i erdhi grada "major", por për arsye të ndryshme doli në lirim.

Në sektorin e Qarkullimit Rrugor, Ismail Bara punoi me shumë përkushtim e ndërgjegje të lartë, duke e konsideruar detyrën si përgjegjësi për mbrojtjen e jetës së qytetarëve. Pikërisht pse e konsideronte si të tillë në aksin rrugor Dibër-Mat-Kurbinit-Krujë, aksidentet rrugore kanë qenë shumë të pakëta. Këtë meritë atij ia njeh më së miri populli i këtyre rrethëve.

QYTETARI MODEL I KURBINIT E MAMURRASIT

Për 14 vjet (1967-1981) Ismail Bara kreu detyrën e drejtorit të Parkut të Automjeteve të Fermës "Skënderbej" Mamurras. Këtu ai u evidentua si kuadri që mbante lidhje të ngushta me qytetarët, të cilët i donte dhe i respektonte dhe ata e donin dhe e respektonin.

Familja e Ismail Barës në Mamurras u bë shembull qytetarie e mikpritjeje. Vetë Ismaili ishte qytetar model. Ai kishte një cilësi të veçantë: iu gjendej njerëzve pranë në çdo rast fatkeqësie, i ngushëllonte dhe u jepte kurajo e forcë me fjalë të zgjedhura e shumë të goditura.

Më 15 maj 1981 Ismaili doli në pension. Mbas këtij momenti deri në ndarjen nga jeta iu përkushtua detyrave në organizatat shoqërore të këtij rrethi.

Ismail Bara gëzonte respekt të veçantë nga i gjithë opinioni publik, jo vetëm në ato rrethet ku punoi e jetoi por nga të gjithë ata që e njihnin. Për merita të veçanta gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe mbas çlirimit, Presidumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar me 8 Urdhëra e

Medalje.

Në vitin 2004, me rastin e 60-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë u dekorua me Medaljen "Për Kontribut të Shquar në Çlirimin e Atdheut".


MISIONARI SHEMBULLOR I PAJTIMIT TË GJAQEVE

Gjatë kohës që ishte në pension ai dha një kontribut të shquar si Anëtar i Misionit Mbarëkombëtar të Pajtimin të Gjaqeve e në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme mes qytetarëve.

Për 15 vjet, brenda e jashtë Kurbinit, me fjalën e tij të urtë e mençurinë e rrallë ka arritur pajtimin e 13 gjaqeve dhe zgjidhjen e dhjetra konflikteve, të cilat shkonin deri në vrasje, pa llogaritur konfliktet e thjeshta.

Një kontribut të veçantë ai ka dhënë edhe si kryetar i Këshillit Sindikal të Pensionistëve e parapensionistëve të rrethit Kurbinit, duke punuar me përkushtim në mbrojtjen e të drejtave të kësaj shtrese. Janë me dhjetra qytetarë që shprehin mirënjohjen ndaj tij për rritjen e masës së pensionit e dhënien e ilaçeve falas, për punësimin e djemve e vajzave të tyre, për ndihmën që u ka dhënë për paratë e humbura në firmat piramidale, për letrat me vlerë etj.

Gjatë tranzicionit të gjatë, Ismail Bara ka dhënë kontribut të çmuar edhe



në aspekte të tjera si për çarmatimin e popullsisë, për hartimin e Kushtetutës, në vendosjen e rendit e qetësisë publike dhe veçanërisht në vlerësimin e figurave të shquara, si të Nënë Terezës, Heroit të Popullit Haxhi Lleshi etj.

Ismail Bara u nda nga jeta më 30 qershor 2016, por ne shokët e tij e kujtojmë vazhdimisht si aktivist dhe drejtues me vlera të mëdha.

HISTORIA

Brigada e XIX Sulmuese dërgoi në Panteonin e Lirisë rreth 100 dëshmorë

Brigada XIX Sulmuese Partizane u krijua në Theollogo, më 30 gusht të vitit 1944. Në Brigadën XIX u rreshtuan partizanë të batalioneve “Pandeli Boçari”, “Thoma Lulo”, “Çamëria”, “Thanas Ziko” dhe “Mateoti” me një efektiv rreth 800 luftëtarë.

Brigada zhvilloi luftime të ashpra kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre vendas, duke u shkakuar atyre humbje të mëdha dhe duke i fituar këto beteja me gjak e sakrificë. Të tilla qenë betejat në Konispol, Delvinë, Qafë Botë, Muzinë, Pec, Zminec, Stugar, Dhrovjan, Libohovë, Qafë e Kışokut e tjera. Të paharruar do të mbetet lufta frontale e 55 ditëve për mbrojtjen e Konispolit dhe heroizmi i partizanëve të Brigadës XIX në çlirimin e qyteteve Delvinë, Sarandë dhe Gjirokastrë.

Brigada e XIX i dha Luftës Nacional-Çlirimtare dhe dërgoi në Panteonin e Lirisë rreth 100 dëshmorë. Brigada XIX u krijua në gjirin e këtij populli



dhe të kësaj krahine që lirinë e kishte dhe e ka të shenjtë dhe që nuk i është trembur kurrë betejave për ta fituar e mbrojtur atë.

Kjo krahinë i ka dashur, u ka dhënë strehë, i ka ushqyer e veshur me fanella leshe të bagëtime të pakta që kishte dhe i ka mbështetur partizanët shqiptarë me të gjithë fuqinë e zemrës dhe të mendjes. Kjo krahinë e ka pasur për nder që për disa dekada ka mbajtur emrin e nderuar zona e Partizanit. Ky emër simbolik i ka bërë nder krahinës, por edhe krahina ka nderuar partizanët shqiptarë e minoritarë që luftuan për çlirimin e atdheut të tyre të përbashkët, Shqipërisë.

Brigada XIX Sulmuese është quajtur ndryshe edhe Brigada e “Vëllazërimit”. Partizanët shqiptarë u rreshtuan krah për krah me vëllezërit e tyre minoritarë grekë dhe luftuan bashkarisht edhe me partizanët italianë të batalionit “Mateoti”. Rrallë gjen një rast tjetër ku vëllazërimit të partizanëve të tre kombësive të ndryshme: shqiptarë, grekë dhe italianë. Kjo dëshmon se antifashizmi është një ndjenjë universale, një vlerë dhe pasuri e të gjithë popujve.

TREGIM

Për tek Porta e Ligjit.....?!



Nga Liljana Muça

Diku, atje në Veri, ku malet e larta e bënë hije njëri-tjetrit, bashkë me fishkëllimën e tërbuar të erës dëgjohej e shurdhër një këmbanë.

Lajmi i kobshëm se kishin vrrarë Lekën, djalin më të mirë të Prelajve mori krahët e erës dhe rendi kullë më kullë e vatër më vatër duke drithëruar zemrat e malësorëve.

Eh, bre burrë, po na shuhen djemtë! Nuk ka të sosur vargu, po na thahet lëngu i shpirtit, -foli njëri plak, tetëdhjetë e kusur vjeç i cili ishte krushqi me Prelajt.

-Për besë kot fare kjo punë, ia priti një plak, - duke thithur thellë duhanin me llullën e gjatë dhe duke nxjerrë prej goje e hundësh një shtëllungë të dendur tymi.

Që nga frëngjia e kullës shekullore, gjakësi, një burri shtatëlartë, rreth të pesëdhjetave dëgjoji bisedën dhe i ndoqi me sy të dy pleqtë të cilët morën rrugën e një shtegu të ngushtë për t'u bashkuar me grumbullin e burrave që e përcillnin për në banesën e fundit trupin e Lekës.

E pat edhe “kjo punë”, mendoi i lehtësuar, por edhe ofshau thellë në një therje në kraharor. Fëmijëria si me dhjetra herë të tjera i kaloi aq qartë përpara syve.

Ishte një fëmijë vetëm dhjetë vjeç atëhere kur nënëmadhja dhe e ëma e kishin vënë të ulj këmbëkryq tek koka e të atit të vdekur, të cilin e kishte prerë plumb i Prelajve.

Edhe atëherë, si tani këmbana kishte rënë vajtueshëm.

Graria ishin mekur duke qarë, kurse axha e burra të tjere të fisit u kishin rënë gjoksit dhe kishin shkullur flokët si shenjë e dhimbjes. Kullat qenë dridhur e trarët u kishin kërcitur për kobin e zi.

Vdekja përgjonte nëpër frengjitë e ngushta dhe nëpër tytat e ftohta të martinave të vjetra.

Kujtimi i hidhur i fëmijërisë për të atin i erdhi si një vegim. “Sa i verdhë, sa i ri dhe sa i bukur me atë cullufe te zezë te derdhur që i kishte rënë mbi ballin e lartë! Po përse, përse”?!

Edhe Leka që tani po i vinte shpatullat dheut, kishte qënë i ri, i bukur dhe shtatëzgan.

Ah, përse?-i tha sërisht vetes duke ndjekur me sy turmën e mugëtuar e kokëulur të burrave që humbën

“Kush hakmerret, ai, bashkë me të tjerët, merr në qafë edhe veten”.

Anerbah

pas Qafës se Lakut. Teksa kapërcyen atë qafë kodre, me një fërgëllimë të fortë shkundëse, iu duk për një çast, se të gjithë ata burra i gllabëroi vdekja.

Fluturimthi, mendja i shkoi tek mësuesi i fillores kur e kishte ngritur njëherë në mësim dhe i kishte thënë të zgjedhonte foljen “mësoj”.

Ai kishte heshtur si guri i një varri, jo se nuk kishte ditur të zgjedhonte atë që i tha mësuesi, por mendja i kishte marrë arratinë me vrapin e një ere të çmendur. Për nga ai çast, kur u ulen pranë të atit të vdekur e për dyzet vjet rresht në vazhdim, kishte mërmëritur me veten e tij, një zgjedhim tjetër të kobshëm “Unë vras, ti vret, ai/ajo vret.....ne vritemi, ju vriteni, ata/ato vriten.....”!

-Përse, përse?!-bërtiti me një piskamë të thekëshme, në të qare, atje në katin e sipërm të kullës së tij, aq sa edhe kulla u drodh nga dhimbja prej hakmarrjes së çmendur.

Ndërkohë hodhi vështrimin përjashta dhe në mugëtirën që po binte, përgjatë shtegut dalloj burrat që po ktheheshin kokëulur të cilët ngjanin si kërcunjtë të zinj se kush me dhimbjen e tij në shpirt.

Iu afrua qoshes pranë oxhakut dhe i hodhi nja dy dru lisi të thatë zjarrit që po shuhej. As i hahej, as i pihej dhe gratë i porositi të mos i sillnin gjë prej gjëje. U mbështet mbi një jastëk të fortë dhe vështrimin e treti me mendime të zymta mbi flakët e zjarrit të cilat zgjateshin dhe merrnin forma të frikshme. Iu duken sikur të ishin flakët e zjarrit të ferrit që zgjateshin drejt tij gati për ta gllabëruar. Pati një makth të vërtetë dhe mornica të forta i shkuan nëpër trup. Degjoi të binte shi dhe të frynte një ere e fortë me fishkëllima.

Po Leka? Ishte atje në dheun e zi e të ftohtë, ndër-sa ai aty në kullën e tij, vërtet i nguuar por ama jetonte.

Ndjeu ta kapnin një palë ethe të forta dhe dhembët filluan t'i kërcisnin sikur të ishte duke ecur në një rrugicë të shtruar me zhavorr. U mundua që të frenonte nofullat, por ato nuk iu bindën. Shiu filloi të bjerë me forcë mbi rrasat e kullës shoqëruar edhe me krisje të ndonjë rrufeje. Një kujisje e përvajshme e qenit të komshiut i vinte në veshë deri lart. Po tani, kujt ia ndillte vdekjen kuisja e tij? Leka ishte atje...

Vijon në faqen 9

LETRAT

Edhe ju jeni trima

Tregim nga Myfit GUXHOLLI



1.

Sapo kishte hyrë prilli i vitit 1944. Gjethet e gështenjave dhe të dushqeve nëpër kodrat përrreth Pogradecit porsa kishin çelur. Nga liqeni frynte një erë e lehtë. Pëtritit, apo Titja, siç e thërrisnin shpesh, dhe shoku i tij Thomai, vështronin sipërfaqen e ujit, së cilës mëngjesi i kishte dhënë një ngjyrë vjollcë në të purpurtë. U ulën të dy mbi një gur dhe vazhduan bisedën:

-Më duket se partizanët do të vijnë këto ditë, - i tha Titja Thomait. Hap sytë që të jesh gati! Dhe... kij kujdes! Askush të mos e marrë vesh se çfarë kemi vendosur!

Thomai tundi kokën me flokët e paqethur, si të donte të thoshte: "Mos u bëj merak!" dhe heshti. Ndërkohë, nga e majta u dëgjua uturima e motobarkës së patrullës gjermane, që shfrynte si bishë e uritur, duke prishur qetësinë e ftohtë.

-Pastaj do të na shohin këta qena neve, -vazhdoi Titja, duke i shkreptirë edhe më shumë ata sytë e kaltër, e duke kërcitur dhëmbët gjithë urrejtje.

2.

Rrinte shtrirë në shtrat dhe sillte ndërmend me gaz në zemër ç'kishte dëgjuar prej më të rriturve... Partizanët e Brigadës IV Sulmuese dhe forcat e batalioneve territoriale kishin çliruar shumë fshatra të rrethit të Korçës, madje edhe Ersekën e Leskovikun. Tërë bota kishte marrë vesh se populli shqiptar, pasi u dha dërmën fashistëve italianë, po luftonte me vetmohim kundër një armiku tjetër të egër e barbar, gjermanëve nazistë...

Papritur u dëgjuan krisma armësh. Ai hodhi jorganin tej me rrëmbim, u vesh me vrull dhe kërcëu nga dritarja, për të arritur sa më parë te shtëpia e Thomait. Brodhi e brodhi përmes errësirës së rrugicës. Pas pak u vuri re tek po vinte drejt tij, duke fishkëllyer lehtë, siç fishkëllente sa herë ishte i gëzuar. Titja iu afrua dhe i pëshpëriti:

- A i dëgjove pushkët? Janë partizanët, me siguri janë partizanët. Të dalim t'i presim!

U sulën pa shkëmbyer asnjë fjalë andej nga ishin ndërjerë krismat. Vraponin të dy me sa u hanin këmbët dhe merrnin frymë me zor prej lodhjes. Fytyrat u shkëlqenin nga gëzimi.

3.

Me luftëtarët u takuan në hyrje të qytetit, tek zinte fill rruga e Mokrës, Eh, se ç'lumturi të patreguar ndjenë në krahëror, kur i panë ashtu me armët supeve, me vështrim të guximshëm e me yllin e kuq në ballë! Por lumturia kishte përfshirë gjithë popullin, se partizanët po e çlironin sërishmi qytetin e djegur nga okupatorët e tradhëtarët.

Çunat u futën në mes të partizanëve. Vazhduan rrugën bashkë me ta dhe sa nuk kërcenin përpjetë, kur luftëtarët i përkëdhelnin, e kur u vinin në kokë kapat e tyre me yje të kuq të ndritshëm.

Porsa arritën tek sheshi ku partizanët qëndruan për të pushuar, dy çunave nuk iu durua. U turrën te komandanti e komisarit, që kuvendonin në mes të një grupi partizanësh. Këta, kur i panë fëmijët, buzëqeshën ëmbël. Titja e Thomai i përshëndetën me grushtin lart:

- Vdekje fashizmit!

Komandantit e komisarit iu bë qejfi dhe nisën t'u shpupurisnin leshrat. Çunave u gufoi zemra. Morën guxim dhe folën pa u ndrojtur:

- Pse nuk na regjistroni në batalion? Duam ta luftojmë edhe ne armikun!

- Vërtet!?- ua ktheu komandanti duke buzëqeshur rishtaz. Pastaj pyeti:

- Shumë mirë! Po, nuk më thoni, nga sa vjeç jini?

- Nga katërmëdhjetë, -u përgjigj Thomai flakë për flakë.

- E shihni, pra! - ndërhyri komisarit duke i vështruar me dashuri, qenkeni ende të vegjël për të ardhur me ne. Lufta është e vështirë.

Tites iu drodh shtati. Hodhi sytë i shqetësuar rreth e rrotull dhe pa një partizan që nuk iu duk më i rritur se ata vetë. Iu afrua shpejt dhe nisi të matej me të. E ai nuk ishte veçse tre gishta më i gjatë.

- Ja, -tha, - sa ne është edhe ai partizani atje.

Komandantit e komisarit u pëlqeu këmbëngulja. Ata i vështruan çunat në bebëzën e syrit.

- Mirë, -ua priti më në fund komandanti. - Po ju regjistrojme.

Pionierët sa s'thirrën prej gëzimit.

...Pas dy orësh u radhitën nëpër rreshtat partizane. Ecnin të lumtur drejt fshatit Podgozhan. E ndjenin veten luftëtarë të vërtetë, sidomos kur i ndanë nëpër baza, e kur njohën dashurinë e madhe të popullit.

4.

Koha rridhte. Dhe ja, erdhi çasti që batalioni po pregatitej për aksion. Me porosi të komandantit e të komisarit, partizanët pionierë do të ishin nën kujdesin e luftëtarit më të vjetër, Shyqyriut. Ai qysh më parë i kishte mësuar ata të qëllonin mirë me pushkë.

- Çdo plumb, - u thoshte, -duhet të godasë në zemrën e armikut. Kuptoni?

Kur arritën në Gurin e Kamjes, batalioni u shpërnda në pozicione. Ai do të priste me zjarr kolonën armike, e cila kishte për qëllim të hynte thellë në malësi. Çunave u rrihte zemra nga padurimi. Ata do të merrnin pjesë për herë të parë në betejë. Dhe, kolona nuk vonoi të dukej. Përleshja filloi e ashpër. Nga të gjitha drejtimet kryqëzoheshin gryka zjarri. Plumbat fishkëllenin mbi krye çast më çast. Partizanëve të vegjël u ziente gjaku e mbusheshin me krenari, kur vërenin se si nuk përmbaheshin shokët, e sidomos kur shikonin se si komandanti i batalionit lëvizte sa andej-këndej në vijën e parë të zjarrit, duke i nxitur luftëtarët ta goditnin armikun me rreptësi. Pas pak u gjend pranë tyre komisarit.

Me t'i parë i pyeti:

- A jini të fortë? -

Të fortë jemi, -u përgjigj Thomai.

Ata u çonin plumba partizanëve dhe ndihmonin infermerien të tërhiqte të plagosurit. Kur papritur, dëgjuan se dikush u thirri rreptë nga pas shpine:

- Ç'bëni more ashtu!?

Titja ktheu kokën. Pa Thomanë dhe një dorë të madhe, që e tërhoqi nga supi dhe e uli barkaz me të shpejtë. Ishte dora e Shyqyriut, që i ruante si djemtë e tij.

- Të mos ju shoh më të ngriheni në këmbë, morët vesh? - bërtiti ai. - S'jemi në dasmë këtu! E dini që mund t'ju kapë plumbi, apo s'e dini? Dhe mos kujtoni se dua t'ju fus frikën, jo! Por, duhet ta kurseni kokën, se lufta nuk ka mbaruar. Ta vrasim armikun dhe të fitojmë.

...Pas betejës komandantit i thirri pranë dy luftëtarët e vegjël.

- Jam shumë i kënaqur prej jush, - u tha ai. - Ju lumtë!

Ata sa nuk fluturuan nga gëzimi, sidomos kur ai u dhuroi nga një armë të re, prej atyre, që iu kapën armikut. Titja e Thomai i morën ato në duar dhe u puthën grykat. Komisarit përsëri iu afrua dhe u rrahu shpatullat.

Erdhi koha për të ngrënë. Po çfarë do të hanin? Skuadra ku bënin pjesë pionierët kishte vetëm një copë çyrek, të cilin e ndanë në kafshata. Kur Titja e Thomai mbaruan së ngrëni racionin e tyre, ndjenë se dikush i preku lehtë në sup. Kthyen kokat dhe panë dy partizanë, që po u zgjatnin pjesët e veta me buzë në gaz. Çunat nuk pranuan. Luftëtarët vrerën vetullat.

- Merrini, de! - thanë. - Ne jemi të rritur e durojmë, kurse ju...


Titja e Thomai deshën të kundërshtonin prapë, por partizanët ua lanë kafshatat mbi gju dhe u ngritën. Nga ajo dashuri dhe kujdes i partizanave pionierët e ndjenë veten dhjetë herë më të përtërirë. Gjithë lodhja e asaj dite iu largua, sikur t'ua kishe hequr me dorë...Të nesërmen s'kishte mbetur për të ngrënë asgjë, përveçse pakëz miell. Për ta shtuar e përzien atë me tallash druri. Arriti çasti kur edhe pionierët partizanë nisën ta përtypnin bukën e çuditshme njëlloj si çyrekun e nënës.. Shokët e skuadrës po i shikonin me vëmendje dhe po i thoshnin njëri-tjetrit me zë të ulët, se edhe ajo ishte një provë e madhe për luftëtarët e vegjël.. Kurse komandanti u vajti atyre pranë dhe u tha me atë zërin e vet të dashur e të kumbueshëm:

- Edhe ju jeni trima, trima të vërtetë. Çdo vështirësi po e kapërceni me sukses.

Pastaj ai u kthye nga batalioni:

- Shikoni, shokë! - tha. As të vegjëlit tek ne nuk duan t'ia dinë për vështirësitë. Kjo tregon se luftën do ta fitojmë patjetër. Partizanët brohoritën. Në sytë e tyre lexohej besimi i patundur se fitorja ishte mjaftë afër.

(Botuar në revistën "Pionieri", dhjetor 1975)



PORTRET

Gazmend Zajmi ka rreth 30 punime shkencore, nga të cilat katër me karakter monorafik

Akademik Gazmend Zajmi, figurë e ndritshme intelektuale e Kosovës

Nga Bashkim Hisari

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, Konferenca e Bujanit dhe Rezoluta e saj për vetëvendosje, Deklerata Kushtetuese për Kosovën Republikë, miratimi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe lufta e UÇK-së për liri, janë ngjarjet më të rëndësishme në historin e re të Kosovës për unifikimin e plotë të faktorit shqiptar për largimin e pushtetit serb nga Kosova dhe shpalljen e pavarësisë së plotë të Kosovës siç e kemi sot.

Tridhjetë vite më pare, më 2 korrik të vitit 1990 për herë të parë Kosova shpalli Pavarësin. Atë ditë delegatët e Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën Kushtetuese të pavarësisë dhe Kosova është shpallur njësi e veçant, në kuadër të federatës të ish Jugosllavisë, Deklerata e pavarësisë u lexua jashtë objektit të Kuvendit të Kosovës në kushte të rrethimit nga forcat policore ushtarake. Me këtë Deklaratë, delegatët e Kuvendit të Kosovës shprehën dhe shpallën qëndrimin burimor kushtetues të popullit dhe Kuvendit të Kosovës si akt i vetëvendosjes politike.

Një ndër figurat politike më të rëndësishme të shpalljes së Deklaratës se Pavarësisë të Republikës së Kosoves, ishte Akademik Gazmend Zajmi, i cili e hartoi Deklaratën e Pavarësisë së 2 korrikut 1990 dhe me këtë akt juridik, artikuloi vullnetin politik të shqiptarëve të Kosovës.

Një personalitet si Gazmend Zajmi duhet kujtuar gjithmonë. Ai ishte shkencëtar patriot i cili e rilindi Universitetin e Prishtinës, pishtar i lirisë së fjalës, lirisë së shtypit, të drejtave të njeriut dhe pluralizimit politik, intelektual poliedrik, i mendjes brilante dhe vizionar që dha shpirtin për Republikën e Kosoves.

Një personalitet si Gazmend Zajmi duhet kujtuar gjithmonë. Ai lindi në vitin 1936 në Krumë (Shqipëri). Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin Juridik dhe shkollën III të këtij fakulteti (drejtimi juridik-politik) i mbaroi në Beograd. Pas studimeve punoi si gjyqtar në Prizren dhe dha mësim në Fakultetin e Drejtësisë



Akademik Gazmend Zajmi (1936-1995)

të Universitetit të Prishtinës. Mbrojti disertacionin e doktoratës më 1972 në Fakultetin e Shkencave Politike të Beogradit me tezën: “Mbrojtja dhe trajtimi kushtetues-juridik i gjuhëve të pakicave kombëtare në Evropë në mes të dy luftërave botërore”. Ishte anëtar i komitetit të përhershëm të konferencës së rektorëve evropianë, i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve në Salzburg dhe Vjenë (Austri). Në kohën e demonstratave të vitit 1981 ishte rektor i universitetit. Mirëpo, autoritetet serbe për 10 vjet dëbuan nga Universiteti.

Gazmend Zajmi ka rreth 30 punime shkencore, nga të cilat katër me karakter monorafik, si dhe është koautor i librit universitar të Universitetit të Beogradit “Sistemi shoqror politik i Jugosllavisë”. Në punimet e tija shkencore veçmas trajtohet

problematika e pakicave kombëtare, aspektet sociopolitike të pozitës së gjuhëve, të autonomisë dhe federalizmit. Ai është autor i një varg eseve politike. Njëherësh është autor edhe i tre librave komponimesh dhe i dy librave vargjesh në fushën e krijimtarisë muzikore dhe të poezisë. Mori pjesë në shumë simpoziume shkencore të vendit dhe ndërkombëtare, si dhe qe anëtar i Redaksisë së Enciklopedisë Politike botuar në Beograd.

Gazmend Zajmi vlerësohet edhe si ndër kontribuesit më të madh për kulturën mbarë shqiptare sidomos me aktivitete që zhvilloi si udhëheqës i grupit të muzikës dhe kompozitor në Shoqërinë Kulturore “Agimi” themeluar në vitin 1944 në Prizren.

Më 26 shkurt 1989 në tubimin e letrarëve të Kosovës, kushtuar Grevës së Minorëve të Trepçës dhe gjithë minorëve të Kosovës, Akademik Gazmend Zajmi ndër tjera tha:

“Shoke minorë të Trepçës dhe minorë të mbare Kosoves, në lumin e gjere të solidaritetit me Ju pranoni dhe zerin tim modest prej individit, prej akademiku dhe kompozitori, të solidaritetit dhe lutjes për shpetimin e shendetit dhe të jetes juaj qe është pa krahasimisht, pa krahasimisht, me e shtrenjte se tere korja e mbufatur politike e ketij nenqielli dhe e tere rruzullit.

Kush do të mund të merrte me mend se kryenqesia dhe arroganca politike, është me e vrazhde, me kercenuese, me gerryese, me perbindeshe se kataklizmat natyrore mbi jeten e njeriut;

Kush do të mund të merrte me mend se edhe shendetit dhe jeta e njeriut plandoset në peshore të ndryshme varesisht nga kryqezimi i vijave të imagjinuara tokesore ku njeriu për here të pare ndeshet me nderrimin e agujve të muzgujve;

Kush do të mund të merrte me mend se edhe nder ata qe djerses se puntorit i kendojne ditirambe dhe panagjerike, një kohe age të gjate do të menjë, do të bezajnë, do të vazhdojne të belbezojnë ballafaqar me të hollimin apo ndoshta edhe akumullimin e lengut të kuq të jetes se mundishme të sperkatur me thrimca dhe djersitjen e shkembinjëve mineralë;

Me në fund, kush do të mund t'i merr me mend dhe shumë e shumë gjera qe koha do t'ua ç'thurë fjet”...



Delegatët e Kuvendit të Kosovës duke votuar Deklaratën Kushtetuese më 2 korrik 1990.

HOMAZH

“Nderi i Shoqatës së Ushtrarakëve” (A.K.U.SH) dega Shkodër

Major DINE XHEKA, modeli më i mirë i oficerit të trupës dhe Shtabit të Ushtrisë Shqiptare

Ali Demushi*

Me 27 qershor 2020 u nda nga jeta Major Dine Xheka, banues në qytetin e Shkodrës, pas një sëmundje të shpejtë e të papritur që pikëlloi thellë familjen e tij, por edhe të afërmit e farefisit kolegët si dhe miqtë e shumtë si brenda dhe jashtë vendit .

Dine Xheka lindi më 26 maj 1950 në fshatin Gjoricë të Dibrës, në një familje me tradita të larta atdhetare e patriotike, ku në vitin 1910 forcat e ushtrisë turke në pamundësi për ta kapur dhe ekzekutuar gjyshin e tij, bashkëluftëtarin e madh të Elez Isufi (Ndreu), pasi ia rrethuan kullën e sulmuan edhe ia dogjën duke e lënë familjen e tij pa strehë, e me gjithë atë ai nuk ia ndau pushkën armikut shumëshekullore për të mbrojtur trojet amtare, në kuadrin e Kryengritjeve të Përgjithshme Shqiptare që çoi në shpalljen e Pavarësisë më 1912 në Vlorë . Dine Xheka pasi përfundoi shkollën shtatëvjeçare në vendlindje, studioi e përfundoi shkollën e mesme ushtarake “Skenderbej” në Tiranë nga viti 1964- 1968, duke dalë me rezultate të shkëlqyera. Menjëherë pas përfundimit të kësaj shkolle, studioi e përfundoi shkollën e lartë të Oficerëve (Shkollën e Bashkuar) dhe u titullua oficer gjitharmësh. U emërua në Brigaden e Këmbësorisë, Rrëshen si oficer trupe me ushtar aktiv dhe oficer shtabi reparti. Duke patur rezultate të larta në punë dhe brenda një periudhe më pak se një dekadë studioi e përfundoi në vitet 70-të Akademinë e Lartë Ushtrake (Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë) duke marrë vlerësimin maksimal. Për-



fundimi i kësaj shkolle e aftësoi për të qënë oficer shtabi. Kështu arriti detyrën e shefit të Shtabit të Brigadës së Këmbësorisë në Rrëshen .

Për nevoja të Ushtrisë, Dinen e kaluan në shkollën e përgatitjes për oficer rezervistë në Vaun e Dejës, në Shkodër, ku kreu detyrën e shefit të planizimit dhe të katedrës, për disa vite .

Me disa riorganizime të njësive e reparteve në ushtri, Dine Xheka u cak-

tua në një detyrë të rëndësishme në Shtabin e Divizionit të Shkodrës, për planizimin dhe gatishmërinë luftarake të reparteve e njësive vartese, në funksion të mbrojtjes së zonës së Divizionit Shkoder , detyrë që e kreu më përkushtimin maksimal.

Dine Xheka ishte një person me figurë të paster morale. Tek ai mishëroheshin cilësitë dhe virtytet më të mira njëzore e qytetare. Ai ishte njeri i thjeshtë, i dashur

me shokët e vartësit, gojëmbël e zemërgjërë, por edhe me një humor të ëmbël e dashamirës që të bënte për vete. Pra ai ishte me shumë vlera të admirueshme.

Dine Xheka ishte modeli i ushtarakut të ushtrisë sonë, komandues e drejtues i aftë për aq kohë sa shërbeu në rradhet e Forcave të Armatosura. Mbas daljes në rezervë (pension), ai u bë një aktivist i dalluar në lagjen ku banoi si dhe në bashkëpunimin me Organizatën e Veteranëve të LANÇI .

Dine Xheka gjatë viteve të fundit ka milituar në Organizatën e Ushtrarakëve (A.K.U.SH) të Shqipërisë, dega Shkodër dhe si anëtarë i kryesisë së saj është dalluar duke marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e organizatës të karakterit patriotik e atdhetar, argëtues e promovues vlerash. Ai ishte e mbetet “Nderi i Shoqatës”.

Është për tu theksuar se Dine Xheka ishte një familjar e prind i përkushtuar.

Dine Xheka e donte Shkodrën, por ç’është e verteta e donte shumë Dibrën, vend-lindjen, njerëzit e tij më të dashur që detyra e ushtarakut ia kishte privuar qëndrimin në gjirin e tyre. Pas daljes në pension i shpesh-toi vizitat në vendlindje.

Pikë të dobët kishte nënën e tij të moshuar dhe ajo që e brengosi për së tepërmi ishte mungesa e pjesëmarrjes së tij në vdekjen e nënës në prill të këtij viti për shkak të pamundësisë që krijoi epidemia virusale e Covid – 19 .

Major Dine Xheka, për rezultatet të larta e merita të veçanta në punë, në kryerjen e detyrave, është dekoruar me urdhëra e medalje të ndryshme.

Ndarja nga jeta para kohe e Dine Xhekes, ka shkaktuar dhimbje shumë të madhe te familja e tij, te të afërmit e farefisi, por edhe tek shokët e kolegët e miqtë e tij dhe që e ndajmë këtë dhimbje së bashku. Fakti që në këto kushte epidemije nuk mundësuan të bënim përcjelljen mortore që meritonte na ka hidhëruar akoma më shumë, por Shoqata jonë (A.K.U.SH) dega Shkodër në një të ardhme jo shumë të largët do të organizojë një ceremoni përkujtimore të veçantë për të nderuar shokun tonë, tashmë të ndjerë Dine Xheka.

Në emër të Organizatës së Ushtrarakëve (A.K.U.SH) dega Shkoder dhe OBVL dega Shkodër i shprehim familjes, të afërmit e farefisit ngushëllimet më të përzemerta për njeriun e tyre të dashur dhe shokun tonë të mirë e të paharruar Dine Xheka, Zoti i forcoftë për të përmballuar këtë dhimbje të madhe !

**I qoftë dheu i lehtë e shpirti i Tij pushoftë në paqe !
I përjetshëm kujtimi i Tij !**

*Kryetar i OBVL, dega Shkodër

Për tek Porta e Ligjit.....?!

Vijon nga faja 6

ndërsa ai aty, i mbërthyer nga një makth torturues.

O Zot i madh, mos po vdiste? Kaq shpejt?! Vetëm një ditë pas Lekës? Po fëmijët e tij? Ah po edhe te Lekës!!!!...

Një përshtjellim marramëndës e gremisi në një realitet të pazakontë. Rrotulloi sytë nëpër rrethinat e dhomës dhe së fundmi i ndali tek dera në fund të saj. Në gjysmë errësirën e ndriçuar vetëm nga flakët e zjarrit në vatër, dalloi një grua të stërgjatë, të fishkur, me flokë të gjatë e të thinjur, shkapërdisur në kraharor e mbi supe. I kallu frikë. Kush ishte vallë?

Deshi ta pyeste, por nuk mundi. Dika e shtrëngoi në fyt dhe djersë të ftohta i mbuluan ballin. Vetëtimthi mbuloi sytë me krahu si në një lojë symbyllazi fëmijësh. Kush ishte ajo grua e shëmtuar dhe çfarë kërkonte në dhomën e tij? Kush

ia kishte hapur derën dhe kush e kishte ftuar? Dhjetëra pyetje i shkonin dhe i vinin me shpejtësinë e vetëtimës, por që nga askush nuk merrte përgjigje. Dëgjoi një krisje të fortë rrufeje, e cila iu duk sikur bëri shkarkimin pas frëngjisë së kullës se tij. Sakaq u zgjua nga përumbja e një bote tjetër. Zemra e çakorduar po i shkallmonte kraharorin. E largoi krahu nga sytë dhe vështrimin e hodhi tek dera, por ajo, Hija e Vdekjes, nuk ishte më aty.

Në veshë i vinin si një litar i gjatë që zgjatej e zgjatej fjalët, që edhe ato të ngujuara në thellësi të vetes, shpërthenin për të dalë nga ngujimi në përmbushje të qëllimit.

“Unë vras, ti vret!!!!...”. Ai varg fjalësh që formonin atë litar të llahtarshëm po e lodhnin dhe po e shtrëngonin për këmbësh, për mesi, për kraharori, ja edhe pak për fyt. Aty ku peri i jetës këputej për tjetër udhë ...

Mjaft ,mjaaft litar i marrë varg i marrë.....! M’u bëre si gjarpër i zi. Do të të

pres me sopatë, do të të bëj copë e çikë, varg i maaarrë!!!!-ulëriti. Kulla e moçme sikur u drodh prej zërit të tij. I kapsalliti syte fort. Edhe stuhia kishte pushuar. Agu i mëngjesit po hynte nëpër frëngjitë e ngushta. U ul ndenjor me këmbët e mbledhura kryq mbi postiqen e leshtë dhe filloi të thithte duhan me një llullë prej druri. Si mbaroi duhanin, që iu bë shkuar formakut, u ngrit dhe zbriti shkallët e ngurta të kullës. Me të mbërritur në korridorin e katit të parë u përball me të shoqen që merrte miell në magje për të gatuar bukët.

-Për ku kështu me kaq ngut?-e pyeti e shqetësuar.

-Për tek Porta e Ligjit. Bëj kujdes për fëmijët,-i tha nxitimthi dhe sakaq kapërcëu pragun.

- Për tek Porta e Ligjit.....?!-tha ngadalë në pëshpëritje gruaja duke ndjerë mbi shpatulla barrën e peshës së një amaneti.

Liljana Muça

PROFILI

ARBEN DUKA ËSHTË NJËRI NGA LIRIKËT TANË MË TË MIRË

SHPENDI TOPOLLAJ

Arben Duka është gjërësisht i njohur, qoftë si parolier, ku me ato tekstet e thjeshta, plot mesazhe e figuracione të mençura, ka fituar shumë çmime në Festalet e Këngës në RTV, ashtu edhe si poet i angazhuar, duke ndjekur pa u lodhur, ecurinë ditore plot teka të politikës, me një lloj stigmatë të pandryshuar, dhe për rrjedhojë shpesh, edhe të keqkuptuar. Them të keqkuptuar, pasi sot, në atmosferën e lirisë së perceptimit dhe të gjykimit, mendimet dhe opinionet janë brenda të drejtës së tyre, që të mos përputhen apo të kundërshtojnë njëra - tjetrën. Dikush, për krijimet e tij të mprehta e lavdëron e dikush që kërkon t'i përçmojë ato, i quan bejte, duke haruar se ato nuk janë tjetër veçse lloje vjershash të përdorura fillimisht në poezinë e popujve të Lindjes dhe që gjetën përhapje edhe në letërsinë tonë. Por kjo nuk ka fare rëndësi dhe ndofta nuk ja vlen të zgjatemi më tej. E rëndësishme, mendoj se është që të dihet e vërteta e pamohueshme, se Arben Duka është një nga poetët tanë lirikë më të mirë. Këtë e vërtetojnë qartazi librat e botuar prej tij, por që për të mos u përhapur shumë, unë po ndalem te përmbledhja "Kristale të thyera", botim i Neraida, viti 2004 me nëntitull Letra dashurie - 6. I drejtpërdrejtë dhe me atë drojë pushkiniane të pafshehur, ai i drejtohet asaj buzë njomës, manushaqe me aromë në lëndinë, me këmbëngulje, pa u mërzhitur aspak ngaqë ajo ngurron t'i përgjigjet. Dhe ndofta ajo djallëzisht tregohet indiferente, se e di se sa më shumë naze të bëjë, aq më shumë do ta joshë atë: "Veç unë e di një të vërtetë / Dhe Zoti atje lart; / Se dashuria është në jetë / Më i vështiri art". Poeti pa tjetër që do të jetë njohur ndonjëherë me atë thënien e Don Marquis - it se "Të bototsh një libër me vargje është sikur të hedhësh petale trëndafil në Grand Kanion dhe të presësh të dëgjosh jehonën e tyre". Ca më shumë që ai e di pozicionin jo fort të lakmueshëm të poezisë të ne sot. E megjithatë, nuk para merakoset për këtë; letrat janë shfrime personale dhe për të, kuptim ka që ndjenjat e tij, apo edhe zhgënjimet që pasojnë,



t'i dijë ajo që është aq e dëshiruar edhe kur kthehet në një vegim apo edhe në një kujtim: "E duron dot zjarrin / A mund të përgjigjesh?!... / Më mirë ëndërrmë / Sa në zjarr të digjesh!..." Mirëpo shpesh lexuesit e zakonshëm dyshojnë se mos poeti duke i kënduar kështu dashurisë, pa dashje ka rënë në pesimizëm. Aspak! Se nuk duhet ngatërruar emocioni që poezia jep, me dëshpërimin apo të parët e fenomeneve të jetës me ngjyrën gri. Paul Gogeni duke vërejtur lidhjen midis saj dhe arsytimit është shprehur "Para së gjithash, emocioni! Vetëm pas të kuptuarit!" Ka pra një ndërveprim të ndërsjellë mes njohurisë së trurit dhe përvojës së shpirtit, sipas A. Bennett. Duke lexuar poezitë e Arbenit, mund të të dalin edhe lot, pasi kujton diçka nga jeta jote, nga dashuria jote, por kjo nuk do të thotë aspak se edhe ti ke rënë në dëshpërim. Jo! Ti tani ndihesh më mirë se kurrë. Kjo është forca përgjithsuese e artit. Arti, me magjinë e tij të çliron dhe të lehtëson. Brenga që të ka munduar, shpërthen. Tani ti ke përjetuar ato çaste që do të doje të mos i harroje asnjëherë. A nuk përftojmë të njëjtën ndjesi edhe nga epika apo drama, dy gjinitë e tjera kryesore të letërsisë? Atëherë, pse e kemi kaq të kollajtë

të themi se poeti ka rënë në pesimizëm? Po si mund të shpaloset tjetërsoj humbja e diçkaje të shtrenjtë, largimi i njeriut të dashur apo vdekja e dashurisë, më të shenjtës gjë që ne njerëzit kemi? "Ikën!... Të gjitha u tretën / Me rininë e përvëlur / Tani veç kujtimet mbetën / Shpirtin për të na helmuar!..." Se vjen një kohë dhe njeriu vyshket fizikisht. Tani çfarë mund të bëjë tjetërsoj ai, veçse: "E ç'të themi e ç'të shkruajmë, / E ç'të themi tani tjetër, / Dalim si gjahtarë të gjuajmë / Kujtime nga kohë e vjetër." Po sikur njeriu të mos ketë se ç'të kujtojë? Si do t'i ngryste ditët? A nuk e quante Maksim Gorki, Aleksandër Bllokun "Njeri me sinqeritet të pacak", kur ai shkruante: "Plot me ëndrra vete - vjen, / Zemra mbart kujtime, fate: / Ato mbrëmje mbi liqen, / Erën e shamizës sate."? Arben Duka poet, me shpirtin e tij të ndjeshëm, rron me shijen e një puthjeje, si te tregimi "Konakbashi". Te poezia e tij "Kush ka puthur..." ai thotë: "Kush ka puthur buzë prej çupe / I ka buzët plot me mjaltë. / Kush ka pirë prej asaj kupe / Nuk ka vdeqje as në baltë". Por mos u çudisni; ai nuk flet për vete. Poeti ka parasysh se kjo u ka ngjarë edhe të tjerëve. Dhe pikërisht këtu është enigma e poetit; ai di të përgjithsojë. Ai shkruan, apo më

mirë, përshkruan, atë që e ka provuar kushdo, me të mirat e të këqiat e veta. Dhe jo vetëm sot, por siç thotë ai te "Jeta...": "Dhjetë shekuj të tjerë kur të shkojnë, / Nip - stërnipërit që do jenë në jetë, / Njëlloj si unë botën do mallkojnë, / Si Zeusi do derdhnin rrufetë". Ndaj ai shpejton të bëjë diçka të mirë: "Le të ecim, kohë s'kemi / Që t'ia fusim gjumit / Le të ndezim, sa të jemi, / Një dritëz mes llumit!..." Ja pse ai, gati u bën thirrje të rinjve e të rejave njësoj si dikur poeti ukrainas Taras Shevçenko që shkruante: "Se me thinja, tërë rrudha / Bëheni një herë, / Dashuroni, sapo jeni, / Lule në pranverë." Shihni dhe lirikun tonë te poezia e tij "Vajtoj...": "Vajtoj për ju sisët e plota, / Të plota mbi gjokse harbuar, / Burimin e shenjtë ku pi bota / Me dritë e me vesë kulluar. / Vajtoj për ju sisët e bardha, / Që ndrisni, sfidoni ylberin, / Do jini dy pellgje të thara, / Burimet nga ju kur të shterin". Ama edhe duhet që dashuria të jetë pa huqe, se pastaj thyhen dhe coptohen zemrat si kristali nga xhelozia. Arben Duka me shpirtin e tij të madh e të kthjellët sa deti i Jugut, dashurinë e ka shtrirë deri te shokët e mësuesit e tij që janë dhe s'janë në këtë botë. Janë vargje të ndjera reminishencash për njerëzit e mirë me të cilët e lidhi fati në jetë, është mirënjohja e pakufishme për ta. Por, ato që të mbesin në mendje e nuk të ndahen, janë vargjet kushtuar vendlindjes së tij Labovës: "Në ato viset e mia / Në Labovë e në Odrie / Ku dhe guri, ku dhe druri / Flasin fjalë dashurie". Por sa meditime përjeton ai te "Kthim në Labovë", ku i dalin parasysh njerëz e ngjarje, ku atij i mbushte shpirti me ngazëllim teksa i del përpara Kala e Dollibashit, Ura e Subashit, me historitë e tyre, lumi Vjosa, Kroji i Kallogresë apo Kisha e Shën Mitrit, ku i bëhen nderime kripës edhe bukës, dhe e sheh me dhembshuri Varri i bardhë i Pilo Dukës. Por sa trishtim e keqardhje ka ai kur sheh se gjërat nuk janë si më parë; kanë ndodhur shumë ndryshime, pasi banorët po largohen nga fshati e po ndërtojnë vila diku tjetër dhe aty thuhajse gjithçka po kthehet në gërmadhë: "Edhe ti, o mik i dashur, / Si një zog do psherëtish: / "Ku u tret ajo muzikë / Që Labovë emrin kish!..." Ajo Labovë që sikurse pohon vetë, e bëri poet Arben Dukën. Pa harruar se ai, si i tillë u kultivua në bankat e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej", nga ku falë mësuesve mjeshtra të shquar të letërsisë, kanë dalë shumë e shumë poetë të tjerë që i bëjnë nder Shqipërisë. Veç liriku Arben Duka me brilantet e tij, zë një vend të veçantë në gjerdanin e pruar të krijuesve të kësaj shkolle. Si i tillë, lexuesit i kalon shkarazi ajo lirika e titulluar "Kënga e fundit", kushtuar sëmundjes së tij të shumë viteve më parë, të cilën ai si një nxënës i Lukianit e përballoi me burrëri. "Në deje gjaku më ka ngrirë / Qiriri në të fikur. / Tani si hëna në të gdhirë, / Jam gati në të ikur." Dhe në qoftëse në shtatorin e vitit 2004 e kishte një merak; se nuk do ta treste dheu për këngët që s'arriti t'i shkruante dot, koha tregoi se qe shqetësuar fare kot, ndaj s'kemi pse të presim këngë nga varri, por nga pena e tij e pashtershme. Romakët e vjetër thonin "Ad augusta per angusta".

GUSHT 2020, NË PUKË E PESË JUBILARË PËRKUJTIMESH DHE PROMOVIMESH

Vijon nga faqja 10

Po arbërit e Komanit të Pukës ishin të njohur edhe si baritor me një blegtori tufash të mëdha (nga e mori emrin Delmace - Delme) në kullotat e rrethinës së Delmacës Pukë, Leja Dushit, kullota e Krrabit ("Monti di Puka") dhe po ashtu në kullotat alpine të Terbunit të Pukës, ku kanë kullotur mijëra bagëti pranë staneve të shumta të lagjeve të Pukës, prej ku ka marrë edhe emrin vendas Terbuni i Pukës (Te t' Bunat, stanet e Pukës); gjithashtu, Terbuni ka edhe prodhimtari këpurdhash ushqimore bashkë me boronica e luleshtrydhe të shijshme.

Por banorët e lashtë të Pukës e të Mirditës kryesisht qenë mjeshtrë të shkrirjes e të përpunimit të metaleve (nga ku morën emrin PIRUST = Zjarr),

si dhe përgatitës të pezhkves (pisë e butë), në pyjet e pafund halorë të Terbunit të Pukës, nga i mbet edhe emri i lashtë, Ad Picaria (Në Pezhve) që prej periudhës Ilire dhe të sundimit Romak, shek. II - IV.

Megjithatë, Prof. E. Çabej nuk e shpjegon emrin e Pukës (PUKË, me zhvillimin fonetik: Pikaria - Pukë, po me Via Publika, si edhe Frang Bardhi.) Në përbërjen e këtyre resurseve hynë edhe BUJTINA, Hani i Përprim Laçit, që përbën një mrekulli të Pukës me disa bujtina komode familjare dhe pistën për skijatorë në çdo stinë të vitit dhe të qitjeve sportive etj.

5. Së fundmi, mund të shënohen edhe sukseset e para pas përpjekjes të gjata më se njëvjeçare të drejtoreshës së përkushtuar të Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Bashkisë së Fushë-Arësit

të zonj. Së nderuar Arina Rrapi, Simoni, e përkrahur prej kryetarit të bashkisë z. Fran Tucit dhe të z. Gjovalin Alia, kryetar i Shoqatës Eko-Turistike të Rrethit Pukë, u arrit që fëmijët e Fushë-Arësit të paraqesin sukseset e para, duke mbushur disa koshere me mëshikëza mëndafshi. Kështu QKF e Fushë-Arësit po vendos lidhjet e lashta me "Udhën e Mëndafshit".

Në vazhdim po merren masat për zbatim masiv fillimisht në familjet e fshatit Kryezi (një nga 100 fshatrat turistike të vendit), si dhe me organizimin e një takimi pune në shkallë rrethi e më gjerë me kujdesin edhe të Ministrisë së Kulturës për vlerësim të arritjeve dhe shkëmbim përvoja për këtë produkt me interes kulturor dhe aq ekonomik në familjet malësore duke rritur të ardhurat e tyre me këtë produkt fitimprurës.

LIBRI

Shënime rreth librit të publicistit të mirënjohur kosovar, nga Prizreni, Bashkim Hisari

HISTORI TRAGJIKE NGA LUFTA SHQIPTARO - SERBE



Dr. Hajri Mandri

Historia e marrëdhënieve shqiptaro-serbe, një histori tragjike që i ndan një lum gjaku, rrjedh nga luftëra e reprezalje të pandërprera që shovinistët serbë kanë bërë mbi shqiptarët e Kosovës. Nuk kanë munguar evidencime të kësaj beteje të gjatë e të përgjakshme nga mjaftë autorë kosovarë e të huaj, por në mënyrë të përmbledhur dhe profesionale, një tablo të luftës së UÇK-së dhe intervenimit të NATO-s për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, e gjejmë të pasqyruar në mënyrë të plotë e panoramike në këtë libër, nga diplomati me përvojë dhe publicisti i shquar Bashkim Hisari.


Në këtë libër të tij, autori na paraqet si në një ekran filmi, imazhe dhe fakte të gjalla nga Lufta në Kosovë, ku me profesionalizëm fikson momentet më kulmore dhe pikante, si në një ese të gjatë përshkruese, me të dhëna dhe argumente shkencorë, me gjetje dhe burime të sakta nga fronti i luftës. Libri përbën një rrjedhë narrative intriguese që të trondit, të shtang dhe të mban pezull me fakte rrëqethëse, duke provuar tortura makabre, deri në çmenduri të pakuptimit të bëra mbi shqiptarët nga barbarët sadistë serbë, si nerv i lig i urrejtjes shekullore etnike. Lënda e pasur e librit me mendime relevante të personaliteteve të shquar, si dhe të viktimave të gjalla e të drejtpërdrejta të Luftës, skenat përshkruese të të vrarëve, përbëjnë imazhe trishtuese që ngjallin presion shpirtëror dhe kuptimin e njëmendtë se kjo barbari duhej të marrë fund në shekullin e paqes dhe të jetës së lirë të kombeve dhe popujve të qytetëruar.

Publicisti Bashkim Hisari ka një qasje të apasionuar për paraqitjen e realitetit me vërtetësinë e kohezionin e plotë politik e historik, në hapësira dhe terrene të identifikuar. Në relacionin kohë-hapësirë, autori është korrekt dhe i saktë, si në një punim shkencor, ku skedon një databazë kronologjike me shumë vlerë për shoqërinë shqiptare dhe më gjerë. Autori, dëshmitar okular i ditëve të vështira që përjetoj shoqëria kosovare, nuk resht të na kapërcejë nga një aksion luftarak në tjetrin, nga një betejë në tjetren, nga një terren i përgjakur në tjetrin. Me mjeshtëri, na sjell shembëlltyrën e skenave si "rrëfimit" brenda rrëfimit", ku insertet dhe digresionet krijojnë te lexuesi emocion, duke e vozitur atë nga tabloja në tablo, të shushatur nën ngërthesa dramatike kontekstuale.

Libri të tërheq, të përmbush estetikisht me shtresëzimet analogjike dhe simbolike në një shkrirje harmonike dhe natyrale të objektivës dhe subjektivës, në rrëfimin herë sintezë, herë polifonik. Monologu e dialogu, fjala e drejtpërdrejtë e protagonistëve kallëzues të intervistuar, enumeracio-

"Akuzohet për gjenocid; bashkëpunim në gjenocid; dëbim; vrasje; përndjekje politike, racore ose fetare; veprime çnjerëzore/ zhvendosje me forcë, shfarosje; burgosje; torturë; vrasje të qëllimshme; burgosje të paligjshme; shkatërrim të vuajtjes së madhe të qëllimshme; dëbim apo zhvendosje të qëllimshme; shkatërrim të gjerë dhe përvetësim të pronës, e pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe e kryer në mënyrë joligjore dhe pa arsye; trajtim mizor; plaçkitje të pronës publike ose private; sulme ndaj civilëve; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të monumenteve historike dhe institucioneve arsimore ose fetare; sulme të paligjshme mbi objekte civile; shkatërrim të qëllimshëm të vuajtjes së madhe".

(Nga Aktakuza e Tribunalit penal ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë kundër Sllobodan Millosheviqit në lidhje me krimet e kryera në Kosovë)



net dhe evidencat situative, koncepti kohë-hapësirë, analogjia dhe aluzioni, zbërthimi i karaktereve të luftëtarëve qëndrestarë dhe heronj, përbëjnë kronotoposin e autorit, si kod kulturor e referencial të tij.

Lexuesi do të ndjekë në paragrafë dhe kapituj të strukturuar me kujdes linjën e pandaluar të Luftës dhe qëndresës që lidhen me këtë hulumtim përmbledhës të korpusit të masakrave serbe mbi popullatën shqiptare. Stili i publicistit është një gërshtetim i formës së shkrimit duke kaluar nga teksti klasik - i lexueshëm (lisibël), në tekstin modern - i shkruarshëm (scritibël). Në këtë rast lexuesi shndërrohet jo thjeshtë vëzhgues, por prodhues refrektiv i situatave psiko-morale dhe estetike duke provokuar ndjenjën e trishtimit, keqardhjes, urrejtjes, dhe krenarisë kombëtare si qëndresë sublimë dhe stoike.

Përshkrimi i situatave të luftës dhe skenave makabre që ofron autori, në të gjitha krerët e këtij libri, detajohet, interpretohet, analizohet dhe ilustruhet me të dhëna konkrete, si burime parësore nga terreni konkret. Në ballafaqimin e ngjarjeve dhe fakteve, padyshim që autori mban qëndrim ideoemocional duke i dhënë veprës mish, gjak e jetë nga botëvështrimi human e atdhetar, i formimit mental dhe shpirtëror të tij. Libri është një rrëfim epik mbi Luftën për Pavarësi e Çlirim të Kosovës që përngjan me poemat homerike të betejave antike. Për ata që shkruajnë, e dinë se sa e vështirë është të kërkosh zanafillën e rrëfimit në kohë, sepse vetë koha e ka zanafillën të rrëfimit. Merita e autorit është se nga një shumësi episodesh,

Kush është Bashkim Hisari

Bashkim A. Hisari-Dauti u lind në Prizren më 1945. Arsimin themelor dhe atë të mesëm i mbaroi në vendlindje, studimet e shkencave politike në Universitetin e Beogradit, kurse studimet pasuniversitare i ka vijuar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Kosovës në Prishtinë ku fitoi titullin akademik Magjistër.

Prej vitit 1966, kur në kuadër të Televizionit të Beogradit filloi për herë të parë emitimi i programit televiziv në gjuhën shqipe, punoi në sajimin e emisioneve dhe emitimin e programit.

Në këtë institucion informativ, së pari si gjirues e pastaj producent, realizator e edhe gazetar reporter, punoi plot 10 vite. Me fillimin e punës së Radio Televizionit të Prishtinës, menjëherë u inkadrua në këtë institucion, ku në redaksinë informativo-politike punoi si gazetar dhe reporter i lirë e më vonë edhe si drejtor i Televizionit të Prishtinës. Dy vite ishte edhe Kryesues i Këshillit programor të Radio Televizionit Jugosllav. Ishte edhe njëri prej themeluesëve të Radio-stacionit regjional të Prizrenit.

Ka ligjruar në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës në Prizren dhe ka ushtruar funksione shoqërore politike. Ka punuar në shërbimin diplomatik të ish Jugosllavisë. Ishte Konsul në Konsulatën e përgjithëshme në Hamburg dhe Stuttgart-RF e Gjermanisë dhe Sekretar i parë i Ambasadës në Bern-Zvicër.

Në Kongresin XIV të LKJ ku ishte delegate, kritikoi politikën e asaj kohe. Regjimi i atëhershëm e largoi nga puna dhe plot nëntë vite mbeti i pa punë respektivisht deri në fillim të vitit 1998 kur punësohet në organizatën ndërkombëtare Humanitarian Laë Center (HLC). Në te, deri në korrik të vitit 2008, punoi si shef i zyrës dhe koordinator i projekti për hulumtimin e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe të krimeve të luftës në Kosovë. Në këtë periudhë bëri hulumtime për krimet e serbëve në Kosovë siç janë masakrimet, dhunimet, burgosjet, keqtrajtimet dhe dëbimet e shqiptarëve nga trojet e tyre. Për këto krime foli në shumë konferanca, tribuna, tryeza të rumbllakëta dhe debate që u organizuan në Kosovë dhe jasht vendit. Rezultatet e hulumtimeve i publikoi në mediat vendore dhe ato të huja.

Është autor i shumë punimeve shkencore dhe publicistike në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e huaja dhe anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (International Federation of Journalists- IFJ) me seli në Bruksel. Ishte shef i Zyrës së Këshillit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë. Është nënkryetar i Organizatës së veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe këshilltar politik në partin Eko Lëvizja e të Gjellbërve të Kosovës.



na ka dhënë një ligjërim të njëzëshëm, të rrjedhshëm dhe të pandalshëm që përshkon librin kryefund. Lexuesi do të ndjekë një rrjedhën rrëfimore, një ujëvarë të trishtë gjaku që derdhet mbi shkëmbenjtë dhe tokën e zhurit të Kosovës së etur për liri.

Brezat e ardhshëm do marrin nga libri mesazhin e luftërave të drejta e të padrejta, ku forcat e kundërta ushtarake-politike, në përleshje homerike dhe sfidë historike, gjeneruan lirinë e

shumëpritur të Kosovës dhe çlirimin e saj nga okupatori historik.

Autori Bashkim Hisari, duke ofruar skena prekëse, të përveçuar me mjeshtëri, ndikon mjaftueshëm tek lexuesi duke sugjeruar besnikërinë e asaj ç'ka sheh dhe dëgjon në lidhje me historinë e rrëfyer apo me karakterin e luftëtarit kosovar. Në diskursin e tij, Hisari është eksplicit por lexuesi duke u bërë përjetues i rrëfimit, nxjerr vetë përfundime, qëndrime dhe vlera.